



VENDIM

Nr. 27 Datë 31.03.2014

PËR

MIRATIMIN E KONTRATËS TIP MBI VERIFIKIMIN E MATESAVE KUR FUTEN PËR HERË TË PARË NË TREG DHE/OSE KUR VENDOSEN PËR HERË TË PARË NË PËRDORIM; INSPEKTIMIN PERIODIK PËR VERIFIKIMIN E SAKTËSISË SË MATËSAVE DHE TË SISTEMIT TË MATJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, KOLAUDIMIN DHE VULOSJEN SI DHE TË MIRËMBAJTJES SË TYRE.

Në mbështetje të neneve 9 dhe 51 pika 9 të Ligjit nr. 9072 date 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike, i ndryshuar nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 31.03.2014, mbasi shqyrtoi draftin e kontratës Tip mbi verifikimin e matesave kur futen për herë të parë në treg dhe/ose kur vendosen për herë të parë në përdorim; inspektimin periodik për verifikimin e saktësisë së matësave dhe të sistemit të matjes së energjisë elektrike, kolaudimin dhe vulosjen si dhe të mirëmbajtjes së tyre,

Vendosi:

1. Të miratojë kontratën Tip mbi verifikimin e matësave kur futen për herë të parë në treg dhe/ose kur vendosen për herë të parë në përdorim; inspektimin periodik për verifikimin e saktësisë së matësave dhe të sistemit të matjes së energjisë elektrike, kolaudimin dhe vulosjen si dhe të mirëmbajtjes së tyre. (bashkëlidhur këtij vendimi).
2. Te shfuqizoje kontratën Tip për shërbimin e kontrollit fillestar dhe periodik të matësave të energjisë elektrike miratuar me Vendimin nr. 62, datë 22.07.2011 “Për Miratimin e Kontratës Tip për shërbimin e verifikimit dhe kontrollit fillestar dhe periodik të matësave të energjisë elektrike”.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektet e interesuara për vendimmarrjen e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
PETRIT AHMETI